



REPUBLIKA E KOSOVËS  
 REPUBLICA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E GJAKOVËS  
 OPŠTINA DJAKOVICA / MUNICIPALITY OF GJAKOVA



**Kuvendi i Komunës së Gjakovës**

**01 Nr. \_\_\_\_\_ /2024**

**Dt. 28.03.2024**

Kuvendi i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 12. Pika (d), nenit 40 pika (J) të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe nenit 18 të Ligjit nr.04/L-010 Për Bashkëpunim ndër Komunal, dhe në nenin 6 të Rregullores nr.0203-1334 për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar të datës 18.12.2012, në mbledhjen e mbajtur me dt. 28.03.2024, pas diskutimeve lidhur më pikën e 5-të të rendit të ditës: Shqyrtimi i Propozim Vendimit për miratimin e Nismës për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar me Komunën Braga -Portugali, e miratoi këtë:

V E N D I M

1. Miratohet NISMA për Bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Braga të Portugalisë .
2. Bashkëpunimin Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës së Braga të Portugalisë, do të bëhet në fushën e Administratës Publike, Ekonomisë, Kulturës Arsimit, Turizmit, Mjedisit dhe të tjera .
3. Autorizohet Kryetari i Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini që ti filloj Konsultimet dhe përgatitjen e Propozim Marrëveshjes për Bashkëpunim Komunal Ndërkombëtar në mes të Komunës së Gjakovës dhe Komunës Braga të Portugalisë .
4. Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen e Komunës.
5. **Vendimi iu dërgohet:**
  - Kryetarit të Komunës së Gjakovës z. Ardian Gjini.
  - Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal .
  - Shërbimit Profesional të Kuvendit të Komunës
  - Arkivit



Ardëneshë Kruji

Kryesuesja e Kuvendit të Komunës





REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA ĐAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Kryetari i Komunës

01 Nr. 011/01-4422

Dt. 21.03.2024

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndërkomunal, nenit 5 nën paragrafi 1.1 dhe Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndërkomunal, si dhe nenit 5 të Rregullores Për Procedurën e Bashkëpunimit Komunal Ndërkombëtar 0203-1334 të dt. 18.12.2012, Kryetari i Komunës paraqet kërkesë për miratimi:

**NISMËN  
PËR BASHKËPUNIM NDËRKOMUNAL ME KOMUNËN E  
BRAGA, PORTUGALI**

NË FUSHËN E ADMINISTRATËS PUBLIKE, EKONOMISË, KULTURËS, ARSIMIT,  
TURIZMIT, MJEDISIT DHE TË TJERA

1. Bashkëpunimi ndërkomunal do të zhvillohet me Komunën e **Bragës, Portugali**;
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e administratës publike, ekonomisë, kulturës, arsimit, turizmit, mjedisit dhe të tjera, duke ofruar dhe pranuar shërbime në fushat përkatëse. Bashkëpunimi do të zbatohet mbi baza të njëjta reciprociteti dhe përfitimit të shumanshëm në mbrojtje të interesit të përgjithshëm publik;
3. Bashkangjitur me nismën gjeni propozim - vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës;
4. **Arsyetimi**- Nisma për bashkëpunimin ndërkomunal me Komunën e Bragës nga Republika e Portugalisë, bëhet me qëllim të thellimit të bashkëpunimit mes dy Komunave në fushat e lartcekura. Duke u nisur nga potenciali për bashkëpunim socio-ekonomik dhe kulturor të të dy qyteteve, si dhe në bazë të iniciativës nga ana e Ambasadës së Republikës së Kosovës në Lisbona të Portugalisë, formalizmi i këtij bashkëpunimi përmes binjakëzimit të qytetit të Gjakovës dhe Bragës është shumë i nevojshëm dhe i mirëseardhur.

Kryetari i Komunës

*Ardian Gjini*  
Ardian Gjini

